



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**Rruga Naim Frashëri Nr 37, Tiranë, ALBANIA**

---

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR EFEKT MARRJEN E  
SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË LËNDËS  
“NJOHURI PËR SHOQËRINË”**

**1) HYRJE**

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të lëndës “Njohuri për shoqërinë” është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit – IZHA, për t’u ardhur në ndihmë të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve, si dhe të gjithë mësuesve të lëndës “Njohuri për shoqërinë” për t’u përgatitur për testimin kombëtar për marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MASH-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumentet zyrtare<sup>1</sup> të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve;
- programet përkatëse lëndore;
- aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie në përgjithësi si dhe të lëndës “Njohuri për shoqërinë” në veçanti,
- përmbajtjen shkencore të lëndës “Njohuri për shoqërinë” sipas programeve lëndore përkatëse.

**2) QËLLIMI I PROGRAMIT**

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të lëndës “Njohuri për shoqërinë” është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të tyre. Programi është hartuar nga grupi i punës duke mbajtur parasysh përmbushjen e dy qëllimeve kryesore:

---

<sup>1</sup> Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASH që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- *Së pari*, të ofrohet si një program orientues për t'u ardhur në ndihmë Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve si dhe të gjithë mësuesve të lëndës “Njohuri për shoqërinë” të arsimit parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese në bazë rrethi. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete.
- *Së dyti*, ai të ofrohet si një program i detyruar, veçanërisht për mësuesit që këtë vit do të marrin shkallët e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje gjithëvjetoje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi synon:

- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjisllacionit arsimor, e në mënyrë të veçantë, të risive më të fundit të reformës arsimore.
- Rritjen e aftësive dhe kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor, drejt një mësimdhënieje të suksesshme.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim.
- Realizimin në praktikë nëpërmjet demonstrimit konkret të aftësive të fituara, e në mënyrë të veçantë, nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

### 3) PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të lëndës “Njohuri për shoqërinë” është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër, për të cilat testohen mësuesit. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës “Njohuri për shoqërinë” që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Programi është ndërtuar duke patur si pikënisje standardet bazë të përgjithshme të mësuesit si dhe në standardet e mësuesit të lëndës “Njohuri për shoqërinë”. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat që mësuesit duhet të zotërojnë në fushën e njohurive dhe aftësive si dhe literatura

përkatëse rekomanduese që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

<b>PËRMBAJTJA E PROGRAMIT</b>	
<b>Fusha : Dokumentet zyrtare</b>	
<b>Rezultati</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë të...</b>	<b>Literatura</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• rrisë përgjegjshmërinë për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor, e në mënyrë të veçantë, të risive të reja të reformës arsimore;</li> <li>• listojë dokumentet kryesore që i duhet çdo mësuesi për realizimin e gjithë procesit mësimor- edukativ;</li> <li>• analizojë udhëzimet ku gjenden shpjegimet për liritë e mësuesit për orët mësimore të parashikuara në programin lëndor;</li> <li>• dallojë pjesët e dokumentacionit që lidhen me mësimdhënien nga ato që lidhen me procesin edukativ;</li> <li>• japë modele orësh të lira në fusha të ndryshme të sociologjisë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dispozitat Normative për arsimin parauniversitar (DN).</li> <li>• Të drejtat e nxënësve (Neni 21)</li> <li>• Qeveria e nxënësve (Neni 37)</li> <li>• Mësuesi, të drejtat e detyrat (Nenet 43,44,45)</li> <li>• Organet kolegjiale në shkollë (Nenet 51, 53. 54)</li> <li>• Udhëzimi Nr. 49, dt. 27.12.2006 i MASH "Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve".</li> <li>• Udhëzimi Nr.38 , dt.09.10.2007 i MASH "Për zhvillimin e orëve të lira në shkollë".</li> <li>• Udhëzimi Nr. 35, dt.09.10.2007 i MASH "Për lirinë e mësuesit për orët mësimore të parashikuara në programin lëndor"</li> <li>• Udhëzimi Nr. 37, dt.09.10.2007 i MASH "Për paraqitjen e personelit të shkollës në mjediset shkollore"</li> <li>• Udhëzimi i MASH Nr. 17, datë 29.06.2010 "Për strukturën dhe planet mësimore në Arsimin Parauniversitar për vitin shkollor 2010-2011".</li> <li>• Udhëzimi Nr. 21, datë 23.07.2010 "Për normat e punës mësimore edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e Arsimit Parauniversitar".</li> <li>• Udhëzimi i MASH, Nr. 26 datë 10.08.2010 "Për mbarëvajtjen e punës mësimore edukative në sistemin e Arsimit Parauniversitar në vitin shkollor 2010-1011.</li> <li>• Udhëzimi i Alterteksit 2010-2011</li> <li>• Rregulloren Nr 4998, datë 27.07.2010 për vlerësimin e nxënësit në gjimnaz</li> <li>• "Kualifikimi i mësuesve – Teste 2008, 2009 2010", botime të IKT-së.</li> </ul>

## Fusha : Programet lëndore

Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë të...	Literatura
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përdorë burime të ndryshme për materiale kurrikulare që ndihmojnë në prezantimin në mënyrë sa më të qartë dhe të dobishme të informacionit që do të shpjegojë;</li> <li>• kombinojë mënyrat bashkëkohore me ato tradicionale për kurrikulat që inkurajojnë nxënësit të kërkojnë, pyesin dhe interpretojnë idetë nga këndvështrime të ndryshme.</li> </ul> <p><u>-Mësuesi thëllon të kuptuarit rreth:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• lidhjes së informacionit teorik që jepet në përputhje me kurrikulën zyrtare me teoritë konkrete të realitetit të përditshëm ku të rinjtë jetojnë;</li> <li>• vlerësimin të kurrikulave në çdo element të tyre;</li> <li>• interpretimin të ideve sipas këndvështrimit të secilit;</li> <li>• synimin të kurrikulës së lëndëve shoqërore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Programi i lëndës “Njohuri për shoqërinë” Klasa IX dhe X</li> <li>• Standardet e nxënies për gjimnazin - IKT, 2009.</li> <li>• Udhëzues për kurrikulën e gjimnazit - IZHA 2010</li> </ul>

## Fusha : Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie

Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë të...	Literatura
<ul style="list-style-type: none"> <li>• trajtojë mësimdhënien si një çështje filozofike;</li> <li>• analizojë mësimdhënien e mirë;</li> <li>• identifikojë natyrën e mësimdhënies;</li> <li>• përshkruajë njohuritë për mësimdhënien;</li> <li>• vlerësojë mësimdhënien si proces dhe praktikë;</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• listojë pasojat e një mësimdhënieje jo të efektshme;</li> <li>• përvetësojë aftësitë për të planifikuar orën e mësimin;</li> </ul> <p><u>-Mësuesi thëllon të kuptuarit rreth:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Matjes së arritjeve të nxënësve lidhur me:             <ul style="list-style-type: none"> <li>– mundësitë që ka secili;</li> <li>– karakterin objektiv të vlerësimit;</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• “Mësimdhënia me në qendër nxënësin” QTKA, 2005 f. 9-25; 29-32; 48-59; 68-71; 123-128.</li> <li>• Buletini “Lëndët shoqërore në fokus të ndryshimeve kurrikulare” Tiranë, 2006: f. 46-55; 56-61.</li> <li>• Metodatat ndërvepruese të mësimin - IKT, 2008;</li> <li>• Braktisja e fshehtë : Objektivat minimalë të domosdoshëm për nxënësin - Tiranë, 2007;</li> <li>• Si t'i hartojmë objektivat e arritjeve të nxënësve: Filozofi, njohuri për shoqërinë. - IKT, 2008;</li> <li>• Vlerësimi dhe hartimi i testeve, histori-</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- kriteret e vlerësimit;</li> <li>- trajtimit dhe respektimit të rubrikave të ditarit;</li> <li>- klasifikimin e objektivave të arritjeve.</li> </ul>	<p>gjeografi: Buletin "Në fokus të ndryshimeve kurrikulare - historia, gjeografia dhe edukatat qytetare"- Klasa e VI, 2005;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i arritjeve të nxënësve Nr. 2 – AVA, Tiranë 2007</li> </ul>
--	--

**Fusha : Përmbajtja shkencore e lëndës**

<p><b>Rezultati</b> Mësuesi do të jetë i aftë të...</p>	<p><b>Literatura</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruajë, listojë, analizojë, shpjegojë, analizojë, vlerësojë e të mbajë qëndrim kritik për probleme lidhur me linjat:</li> <li>• Kultura, individi, shoqëria</li> <li>• Familja</li> <li>• Komunikimi masiv</li> <li>• Feja në fokusin e shqyrtimeve sociologjike</li> <li>• Shoqërizimi</li> <li>• Shkenca dhe teknologjia në perspektivën e trajtimeve sociologjike</li> <li>• Puna dhe sistemi shoqëror i ekonomisë</li> <li>• Popullsia dhe urbanizimi</li> <li>• Shtresimi, ndryshimet dhe lëvizjet shoqërore</li> <li>• Devianca</li> <li>• Raca dhe etniciteti</li> <li>• Metodatat e kërkimeve sociologjike</li> <li>• Edukimi qytetar demokratik</li> <li>• Ç’është demokracia</li> <li>• Faktorët që ndihmojnë dhe pengojnë demokracinë</li> <li>• Funksionimi i demokracisë</li> <li>• Pjesëmarrja qytetare</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti i nxënësit “Sociologji”; “Njohuri për shoqërinë X”</li> <li>• Standardet e përmbajtjes: Edukimi qytetar (për arsimin e detyruar).</li> <li>• Standardet e arritjes: Edukimi qytetar (për arsimin e detyruar).</li> <li>• Programet lëndore: Sociologjia për arsimin e mesëm.</li> </ul>